



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT K R Y E T A R I

*Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë; Tel-Fax: 0693067738*

*E-mail: [bleskaj@klsb.org.al](mailto:bleskaj@klsb.org.al); Web-site: [www.klsb.org.al](http://www.klsb.org.al)*

Nr. 30/27 Prot.

Tiranë, më 04/08/2017

### V E N D I M Nr. 97, Datë 04/08/2017

#### PËR EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË PERFORMANCËS "Performanca e institucioneve përgjegjëse për pranimet në IAL të Maturës Shtetërore 2016"

Në zbatim të planit vjetor 2017, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të përmbushjes së funksionit të tij Kushtetues, zbatimit të Udhëzimeve dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI, EUROSAI etj.), sipas Programit të Auditimit nr. 30/8, datë 10.04.2017, realizoi auditimin me temë "Performanca e institucioneve përgjegjëse për pranimet në IAL të Maturës Shtetërore 2016".

Subjekt i këtij auditimi ishin institucionet përgjegjëse për pranimin në IAL të maturantëve, Ministria e Arsimit dhe Sportit; Agjencia Kombëtare e Provimeve; Universiteti i Tiranës; Universiteti i Mjekësisë, Tiranë; Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër; Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan; Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës; Universiteti "Ismael Qemali", Vlorë.

Faza e terrenit të auditimit nisi në dt. 11.04.2017 me Programin e Auditimit nr. 30/8 prot, datë 10.04.2017.

Në respektim të afatit 1-mujor, grupi i auditimi priti observacionet nga subjektet nën auditim, duke organizuar edhe takime ballafaqese me disa prej tyre. MAS, AKP, RASH, UT, UE "AXH" dhe UV "IQ" përcollën observacionet e tyre brenda afatit ligjor. Dy subjektet e tjera, Universiteti i Shkodrës dhe ai i Durrësit nuk përcollën observacione, duke pranuar në heshtje projekt-raportin auditues. Për shkak të volumit të observacioneve të paraqitura, ato janë përfshirë në fund të raportit në anekset përkatëse të ndara sipas subjekteve, sëbashku me argumentimin e grupit të auditimit dhe qëndrimin final të KLSH-së për to. Në rastet kur observacionet e subjekteve kanë sjellë në vëmendje të grupit të auditimit, informacion shtesë, të paaudituar më parë, ndryshimet janë bërë nga vetë grupi i auditimit, duke dhënë shpjegimet e nevojshme në shënimin përkatës, në fund të faqes respektive.

Në përfundim, pasi u njoha me raportin përfundimtar të auditimit dhe projekt-vendimin e paraqitur nga grupi i auditimit, të Departamentit të Auditimit të Performancës, shpjegimet e dhëna nga subjektet e audituara<sup>1</sup>, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i

---

<sup>1</sup> Observacionet e subjekteve mund të gjenden në linkun vijues për MAS: <https://drive.google.com/open?id=0BydIZhg5y5F5c3V0QIZwVFYtdWM>.

Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi dhe Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 15, shkronja “c” të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”:

### KONKLUDOVA:

Arsimi i Lartë është shërbim dhe e mirë publike dhe pranimi i kandidatëve në IAL-të, përmes procesit të Maturës Shtetërore, duhet të bazohet në parimin e mundësive të barabarta, ku në themel të tij të qëndrojë konkurrenca, e realizuar përmes garantimit të parimit meritë-preferencë. Angazhimi i KLSH-së në auditimin e performancës së institucioneve përgjegjëse për pranimin në Institucionet e Arsimit të Lartë të Maturës 2016 pati si shtysë problemet e konstatuara dhe të evidentuara mediatikisht në periudhën Shtator-Tetor të 2016-s.

Arsimi i lartë në Shqipëri ofrohet dhe zhvillohet në IAL-të publike dhe jopublike, në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë dhe Ligjin për Arsimin e Lartë<sup>2</sup>. Në grupimin e parë bëjnë pjesë IAL-të me financim të drejtpërdrejtë nga fondet publike, ndërsa në grupimin e dytë bëjnë pjesë dy tipe të IAL-ve: jofitimprurëse dhe fitimprurëse, ku këto të fundit nuk përfitojnë financim nga fondet publike.

Arsimi i lartë është e mirë dhe përgjegjësi publike dhe ka për mision: a) të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor, si dhe të nxisë e të zhvillojë artet, edukimin fizik dhe sportet; b) të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend; c) të ofrojë mundësi të barabarta për të përfituar nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës; ç) të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal, si dhe në forcimin e sigurisë publike dhe kombëtare; d) të mbështesë prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit; dh) të integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor; e) të nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë.

Duke qenë të vetëdijshëm se procesi i marrë nën auditim ishte i pari që realizohej në kushtet e Ligjit të ri të Arsimit të Lartë 80/2015 dhe si i tillë nuk përfaqëson një proces të maturuar, shtresëzuar e konsoliduar, ku të gjitha palët pjesëmarrëse të njohin të drejtat dhe detyrimet e tyre e t'i zbatojnë ato me efektivitet, grupi auditues riskoi me auditimin e një veprimtarie të tillë, me synimin që të hidhte dritë mbi modelin që po prezantohej e implementohej për të ndërgjegjësuar të gjitha palët pjesëmarrëse në të dhe ndërmarrë veprimet korrektuese përpara se të ishte vonë. Sinjalet që modeli kishte të meta u morën fillimisht nga konteksti social i problemit, ku maturantët të cilët aplikuan për pranime në IAL për vitin akademik 2016-2017 e shprehën pakënaqësinë e tyre mediatikisht, përmes protestave të shpeshta në periudhën e pranimeve dhe përgjithësisht duke theksuar se Ligji i ri i Arsimit të Lartë deformonte meritë-preferencën e synuar.

Në lidhje me pyetjen kryesore të këtij auditimi: *A u implementua nga institucionet përgjegjëse, modeli i dubur për pranimin në IAL të maturantëve në vitin akademik 2016-2017?*”, u arrit në këtë mesazh:

**Modeli i pranimet që u aplikua në vitin 2016 dhe po përpiqet të implementohet sërish, nuk është ai i duhuri, si në konceptim, ashtu edhe në aplikim. Ky model nuk është në përputhje me frymën e Ligjit 80/2015 dhe as me praktikat e mira të vendeve perëndimore prej nga ky Ligj është përshtatur.**

---

<sup>2</sup> Ligj nr. 80/2015, datë 22.7.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL..."

MAS dhe QSHA duhet të angazhohen aktivisht në procesin e aplikimit, duke e nisur më herët atë në kohë, asistuar aplikantët dhe IAL-të në kërkesat e tyre për mbarëvajtjen e duhur të procesit kundrejt tarifave të arsyeshme dhe kryerjen e procesit të regjistrimit të fituesve pa interferuar me procesin e pranimit, por në fund të tij, mbështetur në listat përfundimtare të dërguara nga IAL-të.

IAL-të duhet ta konceptojnë, dizenojnë dhe implementojnë vetë procesin e pranimit, në përputhje me Ligjin dhe praktikën e mira. Kriteret e tyre e të pranimit duhet të reflektojnë një politikë afatgjatë të tyre, që t'i mundësojë aplikantëve profilizimin potencial në arsimin e mesëm, sikurse nuk duhet të kufizohen vetëm në përlllogaritjen e mesatareve, por mund të përfshijnë edhe aspekte të tjera të vlerësimit të kandidatëve, sidomos për programet e preferuara të studimit.

Nisur nga konkluzionet e mësipërme të veprimtarisë audituese, duke synuar përmirësimin e mëtejshëm të rezultateve në këtë sektor:

## V E N D O S A:

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit të Performancës “Performanca e institucioneve përgjegjëse për pranimet në IAL të Maturës Shtetërore 2016”;

**II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave për sa vijon:

Për pyetjen: **A u respektua Ligji 80/2015 nga ana e MAS përgjatë procesit të pranimit në IAL për vitin akademik 2016-2017?**

Aplikimi i maturantëve për pranimet në IAL në vitin 2016 u rregullua nga Udhëzimi nr. 13 datë 22.07.2016 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2016-2017”. Lidhur me këtë udhëzim fillestar:

- a) Nuk dokumentohet zyrtarisht grupi i punës që duhej të përgatiste këtë akt normativ shumë të rëndësishëm për procesin e pranimeve të kandidatëve për studentë në IAL.
- b) Nuk kishte referencë të qartë në nenet e Ligjit 80/2015, ndonëse në intervistat me titullaren e MAS dhe titullarët e IAL-ve, pohohet se baza ligjore e udhëzimit ka referencë të nënkuptuar pikën 4 të nenit 9, përmendur më lart.
- c) Nuk i referohej QSHA-së, që Ligji e parashikon si institucionin përgjegjës për koordinimin e procesit të aplikimit në IAL. Në vend të saj, Udhëzimi udhëzonte IAL-të dhe maturantët që të viheshin në marrëdhënie me Agjencinë Kombëtare të Provimeve. AKP është krijuar me VKM nr. 1013, dt. 10.12.2010, në mbështetje të Ligjit 10171, dt. 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”. Në pikën 8, gërma “e” e VKM-së nr. 1013 specifikohet se AKP: “Krijon një sistem unik dhe transparent për përcaktimin e kandidatëve fitues në programet e studimit, sipas parimit meritë-preferencë”. I njëjti funksion ritheksohet edhe në statutin e AKP-së, miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Sportit me nr. 5263/1 Prot. dhe dt. 20.08.2014. Kjo pikë e kësaj VKM-je bie ndesh me Ligjin 80/2015 dhe, në përputhje me nenin 142 të po këtij Ligji, AKP nuk mund të vazhdonte të luante funksionet e saj në procesin e pranimit në IAL të maturantëve për vitin 2016 e në vijim. Vendin e saj duhet ta zinte QSHA-ja, aktet nënligjore për të cilën duhet të ishin

miratuar brenda 9 muajve nga data e hyrjes në fuqi të Ligjit 80/2015 (05.10.2015), pra në 05.07.2016<sup>3</sup>, por që në fakt nuk ishin miratuar.

- d) Udhëzimi nr. 13 e dizenjoji procedurën e pranimit të maturantëve në IAL, duke kapërcyer rolin ligjor të Ministrisë në proces, që e kufizon atë vetëm në procesin e aplikimit dhe atë të regjistrimit final. Konkretisht: 1) Udhëzimi 13 **unifikoi** intervalin kohor të pranimeve për të gjitha IAL-të në nivel Republike, duke **specifikuar** gjithashtu ndarjen në runde e më tej në faza të ndërmjetme; afatet e ankimimit; përcjelljen e informacionit në fund të çdo raudi apo faze tek AKP; afatet e shpalljes së listave të ndërmjetme e përfundimtare për çdo raud, etj.

**Udhëzimi 13 përcaktoi procedurën e pranimit të maturantëve në IAL (publike dhe jopublike), duke shkëlur kështu nenin 25, pika 8 të Ligjit 80/2015,** ku specifikohet qartë se **pranimi i maturantëve në IAL bëhet nga vetë IAL-të, në përputhje me procedurat e përcaktuara në Statutin dhe Rregulloren e tyre.** 2) Udhëzimi iu hoqi mundësinë maturantëve dhe IAL-ve që të bënë pranimin e studentëve ekselentë në 2 programe studimi njëkohësisht, sikurse e parasheh neni 85, pika 1 e Ligjit 80/2015. Po kështu, Udhëzimi iu hoqi mundësinë maturantëve të regjistruar në një program studimi, që të ç'regjistroheshin dhe të regjistroheshin në një program tjetër studimi, sikurse e parasheh neni 54, pika 7 e Kushtetutës së RSH: "Arsimi i mesëm profesional dhe i lartë mund të kushtëzohet vetëm nga kritere aftësie". 3) Udhëzimi e përqendroi procesin e pranimit në një platformë të vetme elektronike, administruar fillimisht nga AKP e më pas nga RASH. Ky përqendrim penalizoi maturantët dhe IAL-të të cilat kishin kërkesa për pranime edhe pas afatit kohor të përcaktuar në mënyrë unike nga MAS.

- e) Udhëzimi nr. 13 u ndryshua 5 herë brenda një periudhe 3-mujore, duke detajuar apo ndryshuar udhëzimin fillestar.
- f) Udhëzimi i MAS-it iu dërgua paraprakisht në formë drafti për vjelje mendimesh IAL-ve.
- g) Udhëzimi i MAS-it, në ato pjesë ku interferonte me procesin e pranimit, nuk u kontestua nga asnjë IAL, por përkundrazi, u detajua me udhëzime të tjera në nivel IAL-je dhe u implementua plotësisht.
- h) Vetë MAS nuk e zbatoi Udhëzimin nr. 13, sepse vazhdoi me regjistrimin dhe matrikullimin e afro 800 aplikantëve vetëm për IAL-të jopublike edhe pas afatit kufi, dt. 01.11.2016. Këto regjistrime vijuan të bëheshin përmes grupeve të punës të ngritura nga Sekretari i Përgjithshëm i MAS. Në shkresat që Sekretari i Përgjithshëm i përcjell Drejtoreshës së Përgjithshme të AKP-së thuhet: " Universiteti/SHLJU ... me shkresën nr. ..., dt. ..., i është drejtuar MAS-it me kërkesën për regjistrimin e studentëve të pranuar/transferuar, të cilët për arsye objektive **nuk kanë mundur të regjistrohen** në sistemin online të pranimeve apo që **kanë aplikuar jashtë afateve të përcaktuara** në Udhëzimin e MAS, nr. 13, dt. 22.07.2016, i ndryshuar." Shumica e korrespondencës midis dy zyrtarëve të mësipërm i përket muajit Dhjetor 2016 dhe shtrihet deri në muajin Mars 2017, pra pasi kishte nisur viti i ri akademik 2016-2017.
- i) Për vitin akademik 2017-2018, MAS ka nxjerrë një udhëzim të ngjashëm me atë të vitit të kaluar për të rregulluar procesin e pranimeve në IAL, me ndryshimin që aplikantët ekselentë mund të regjistrohen në më shumë se një program studimi dhe kanë të drejtë të ç'regjistrohen brenda një date të specifikuar në udhëzim.

## Konkluzione

- a) Për sa më lart, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka shkëlur Ligjin 80/2015 duke:

---

<sup>3</sup> Neni 141 i Ligjit 80/2015.

1. Nxjerrë një udhëzim në kundërshtim me ligjin, sepse përmbajtja e këtij udhëzimi bie ndesh me nenin 25, pika 8 të Ligjit 80/2015;
  2. Mos nxjerrë në kohë aktet nënligjore për QSHA-në, që do të koordinonte procesin e aplikimit, sikurse parashihet në nenin 141 të Ligjit 80/2015.
  3. Penguar parimisht aplikantët ekselentë fitues të regjistroheshin në 2 programe studimi njëkohësisht, sikurse parasheh neni 85, pika 1 e Ligjit 80/2015.
  4. Penguar aplikantët fitues në 2 apo më shumë programe studimi të ç'regjistroheshin e më pas të regjistroheshin në programin e dëshiruar, në përputhje me nenin 54, pika 7 e Kushtetutës.
  5. Përfshirë në procesin e pranimit, subjekte të cilat nuk duhet të ishin përfshirë në bazë të Ligjit 80/2015, sikurse është rasti i AKP-së, apo që nuk parashikohen nga Ligji 80/2015, sikurse është rasti i RASH.
  6. Regjistruar në IAL-të jopublike persona që nuk kishin aplikuar në përputhje me Udhëzimin nr. 13, pas datës kufi të përcaktuar në Udhëzim dhe pasi kishte nisur viti i ri akademik 2016-2017.
- b) Shkelja e Ligjit nga ana e MAS u krye pjesërisht në kushtet e keqinterpretimit të nenit 9, nën i cili bën fjalë për procedurat e regjistrimit në QSHA dhe jo në IAL dhe pjesërisht nga mungesa e planifikimit në kohën e duhur për nënproceset që MAS dhe strukturat e saj janë përgjegjëse në procesin e pranimit, duke rritur artificialisht emergjencën e procesit. Në vende të zhvilluara, si Mbretëria e Bashkuar, Holanda, Gjermania, etj., procesi i aplikimit nis 6-12 muaj përpara fillimit të vitit ri shkollor për aplikantët e ciklit të parë të studimeve, ndërkohë që në Shqipëri, në 2016, procesi i aplikimit nisi rreth 2 muaj përpara fillimit të vitit ri shkollor dhe u mpleks e interferoi tek procesi i pranimit.
- c) Shkelja e ligjit nga ana e MAS ndikoi në ekonomikitetin, eficiencën dhe efektivitetin e procesit, duke sjellë shpenzime financiare nga palët e përfshira në proces, raport jo të drejtë input-output dhe deformim të pjesshëm të parimit meritë-preferencë, sikurse detajohet në seksionet vijuese të këtij raporti.
- d) Në programin e auditimit, grupi i punës hodhi hipotezën se përfshirja e MAS në procesin e pranimit u diktua nga performanca e dobët dhe përfshirja pasive e IAL-ve në vitin 2016, por, nxjerrja e një Udhëzimi të ngjashëm edhe për vitin akademik 2017-2018, sikurse analizimi me kujdes i evidencave shkresore e intervistave gjatë fazës analitike të auditimit, krijon bindjen e arsyeshme se MAS është përfshirë jo për shkaqet e mësipërme, por për të centralizuar procesin.

## **Rekomandime**

Për sa më lart, KLSH i rekomandon MAS:

- a) Të bëjë një interpretim koherent të Ligjit 80/2015 dhe në përshtatje me praktikën e mira të vendeve perëndimore nga ky Ligj është përshtatur, duke mos nxjerrë udhëzime që rregullojnë apo interferojnë me procedurën e pranimit të aplikantëve në IAL. Ky proces, në tërësinë e vet (konceptim, dizënjim, implementim), i përket njësisë kryesore dhe atyre bazë të IAL-ve në përputhje me Statutin dhe Rregulloret e tyre.

**Në vazhdimësi**

- b) Të shfuqizojë Udhëzimin nr. 15, dt. 19.05.2017, "Për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit ..., për vitin akademik 2017-2018".

**Menjëherë**

- c) Të regjistrojë në QSHA e pajisë me numra matrikullimi të gjithë ata aplikantë fitues që janë pranuar konform kriterëve nga IAL-të publike për vitin akademik 2016-2017, në ose pas datës 1 nëntor të specifikuar si datë e mbylljes së regjistrimeve me Udhëzimin nr. 25, dt. 27.10.2016, por përpara fillimit të vitit të ri akademik. Nga të gjitha IAL-të e përfshira në këtë auditim, u konstatuan 25 raste të tilla që ishin pranuar e regjistruar në Fakultetin e Ekonomisë së UT, por mund të ketë edhe raste të tjera në IAL-të publike të papërfshira në këtë auditim.

**Menjëherë**

- d) Të ç'regjistrojë nga QSHA, duke iu hequr numrat e matrikullimit, të gjithë atyre personave të regjistruar në IAL-të jopublike, të cilët nuk aplikuan për pranime në vitin akademik 2016-2017 konform Udhëzimit nr. 13, dt. 22.07.2016, si edhe aplikantëve që u pranuan në këto IAL jopublike pas fillimit të vitit të ri akademik 2016-2017.

**Menjëherë**

- e) Ta hapë procesin e aplikimeve për në IAL, përmes QSHA-së, më herët në kohë, në përputhje me eksperiencat botërore dhe duke iu dhënë mundësi kështu IAL-ve nga njëra anë të përllogarisin kuota më realiste pranimesh, të aplikojnë filtra shtesë për të njohur e vlerësuar aplikantët, etj., sikurse për të ndihmuar e orientuar aplikantët nga ana tjetër që të njohin paraprakisht konkurrencën në programet e preferuara dhe ndërmarrin hapat e duhura për të përmirësuar shanset për sukses.

**Në vijimësi**

**Për pyetjen: A u respektua Ligji 80/2015 nga ana e IAL-ve përgjatë procesit të pranimit të maturanëve në vitin akademik 2016-2017**

IAL-të u përfshinë në procesin e pranimeve 2016 duke përcaktuar kriteret e pranimit, kuotat e pranimit, si edhe zbatuar direktivat e Udhëzimit 13, të ndryshuar. Në përcaktimin e kriterëve, ndonëse neni 23, pika 4 e Ligjit e bën të qartë se janë fakultetet ato që miratojnë kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi, IAL-të e audituara i miratuan kriteret përmes vendimeve të Senateve Akademike, një akt i panevojshëm ky, nisur nga dispozitat ligjore. Ndonëse Ligji nuk shprehet për ndryshimin e kriterëve pasi ato janë shpallur nga IAL-të për atë vit akademik, një pjesë e mirë e IAL-ve të audituara apo njësive kryesore brenda këtyre IAL-ve, i ndryshuan kriteret e tyre të pranimit më shumë se një herë në vitin 2016.

Udhëzimi nr. 13 i është përcjellë në formë drafti për vjelje mendimesh Rektorateve të IAL-ve, sëbashku me 17 akte të tjera nënligjore, në dt. 11.07.2016 nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të MAS. Në e-mailin zyrtar me të cilin Sekretari i Përgjithshëm iu kërkon mendime Rektorëve, është lënë afat për kthimin e komenteve një javë pune. Në intervistat që grupi i punës realizoi me Rektorët e IAL-ve nën auditim, një pjesë prej tyre konfirmuan marrjen e draft-udhëzimit, ndërsa një pjesë jo. Rektorët që konfirmojnë marrjen e draftit, pohuan në intervistat me KLSH-në se ia kanë përcjellë atë drejtuesve të njësive kryesore, por përsëri, një pjesë e drejtuesve të njësive kryesore kanë kthyer përgjigje se nuk janë në dijeni të një drafti të tillë, ndërkohë që ata që e kanë marrë shprehen se numri i madh i akteve dhe koha e shkurtër në dispozicion, e bënte praktikisht të pamundur gjenerimin e komenteve, përfshirë edhe Udhëzimin nr. 13. Rrjedhimisht, asnjë nga IAL-të dhe njësitë kryesore brenda tyre nuk gjeneroi komente apo observacione për Udhëzimin nr. 13 me përjashtim të Universitetit të Tiranës që, në dokumentacionin e vënë në dispozicion të KLSH-së, shprehet i shqetësuar për ligjshmërinë e Udhëzimit, por vetëm për pranimet në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve. Po kështu, kjo IAL i kthen vërejtje MAS-it se: i) "Fazat e regjistrimit të studentëve duhet të përcaktohen nga

vetë IAL-të”, ii) “Nëse sekretaritetë universitare përfshihen në përlllogaritjen e pikëve të aplikantëve dhe rankimin e tyre, pagesa e punës të bëhet nga QSHA, e cila arkëton një tarifë aplikimi për shërbimin që iu kryen aplikantëve për studentë” dhe iii) “Kapitulli për fazën e tretë të aplikimeve dhe regjistrimeve për IAL-të jopublike duhet të hiqet, pasi cënon barazinë e studentëve dhe institucioneve”. Nga këto tri sugjerime, MAS reflektoi vetëm të fundit në Udhëzimin e miratuar. Dokumentacioni i vënë në dispozicion të KLSH-së nga UT për komentet e mësipërme është fotokopje e korrespondencës origjinale dhe, në përputhje me parimet e auditimit, besueshmëria e një dokumenti të tillë është plotësisht e garantuar.

Ligji 80/2015 parasheh që IAL-të do ta realizojnë procesin e pranimeve të aplikantëve për studentë sipas procedurave të përcaktuara në Statutin dhe Rregulloret e IAL-ve.<sup>4</sup> Nga intervistat e realizuara me IAL-të nën auditim, të gjitha pohojnë se në procesin e pranimeve për vitin akademik 2016-2017, nuk kanë patur në fuqi Statut dhe Rregulloret mbështetur në Ligjin e ri të Arsimit të Lartë dhe se po punojnë për hartimin dhe miratimin e tyre. Neni 132 i Ligjit shprehet mbi afatet e miratimit të dokumenteve të tilla, duke përcaktuar si kufi kohor vitin e parë akademik nga momenti i miratimit të ligjit. Ligji 80/2015 ka hyrë në fuqi më dt. 05.10.2015, ndërkohë që viti i parë akademik nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij Ligji shtrihet në periudhën 12.10.2015 – 30.09.2016.<sup>5</sup> Në momentin e hartimit të këtij raporti, të gjitha IAL-të e audituara nuk kanë miratuar Statutet dhe Rregulloret e tyre, me argumentin se MAS ende nuk nxjerrë aktet nënligjore që do ta mundësonin një gjë të tillë.

Me hyrjen në fuqi të Udhëzimit nr. 13, më dt. 22.07.2016, të gjitha IAL-të nisën ta implementojnë atë, një pjesë e të cilave duke nxjerrë edhe udhëzime në nivel Rektorati, që e detajonin më tej. Në të gjitha intervistat e realizuara me IAL-të e përfshira në auditim, titullarët e tyre janë shprehur se e gjejnë plotësisht të mbështetur në Ligj përmbajtjen e këtij udhëzimi dhe të atyre që e pasuan, duke e ndryshuar atë.

Përlllogaritja e pikëve të maturantëve dhe rankimi i tyre, ndryshe nga vitet e kaluara ku realizohej nga AKP, u realizua në pranimet e vitit 2016 nga vetë IAL-të. Kjo pjesë e procesit i gjeti të papërgatitura pothuajse të gjitha IAL-të, të cilat e kuptuan se duhet ta kryenin vetë këtë përlllogaritje në momentin kur AKP iu përcollti të dhënat elektronike të maturantëve në dt. 30.08.2016. Listat paraprake të fituesve duhet të shpallëshin në dt. 05.09.2016. Koha e shkurtër në dispozicion dhe pas periudhës së pushimeve verore, shoqëruar me mospërgatitjen paraprake të IAL-ve, çoi në punën me orare të tejzgjatura dhe ngarkuar me stres të një pjese të stafit akademik dhe administrativ të tyre. Nga IAL-të e audituara, vetëm UT ngriti grup pune për ta realizuar përlllogaritjen e pikëve me burimet e veta njerëzore, ndërsa IAL-të e tjera kontraktuan Rrjetin Akademik Shqiptar, duke paguar shuma monetare. Përfshirja e RASH-it në përlllogaritjen e pikëve të maturantëve për llogari të IAL-ve u realizua përmes një marrëveshjeje tip, të legjitimuar nga Vendimi Qarkullues i Komitetit të Programimit dhe Drejtimit të këtij subjekti me nr. 1, dt. 28.08. 2016, Kryetar i të cilit është titullari i MAS.

Përzgjedhja e RASH nga ana e Universitetit të Mjekësisë, Elbasanit, Shkodrës, Vlorës e Durrësit, nuk u krye përmes një procedure prokurimi apo përgjithësisht konkurrimi, sikurse ndodh rëndom në institucionet e tjera publike. Vetë Ligji 80/2015 në nenin 3 të tij, kur adreson autonominë financiare të IAL-ve, shprehet se “fondet duhet të përdoren në përputhje me legjislacionin në fuqi”, dhe më tej në nenin 109, pika 3, shprehet se përveç fondeve të akorduara nga Buxheti i Shtetit, IAL-të rregullojnë me aktet e tyre të brendshme mënyrën e përdorimit të fondeve. Në intervistat e zhvilluara me titullarët e IAL-ve të mësipërme, asnjë prej tyre nuk gjeneroi akte ligjore e rregullative të vlefshme, mbi bazën e të cilave ndoqën

---

<sup>4</sup> Neni 25, pika 8 e Ligjit 80/2015.

<sup>5</sup> Urdhri nr. 298, dt. 19.08.2015, nr. prot. 60.86, “Për caktimin e datës së fillimit të vitit akademik 2015-2016 në IAL.”

procedurat për të përzgjedhur RASH-in për të realizuar procesin e përllogaritjes së pikëve dhe rankimin e aplikantëve për pranimet në vitin akademik 2016-2017.

Për më tepër, Marrëveshjet që këto IAL lidhën me RASH u firmosën nga Rektorët e këtyre IAL-ve, duke mos u miratuar nga Bordi i Administrimit të IAL-së përkatëse dhe mos u firmosur nga Administratori i saj, sikurse Ligji 80/2015 parasheh në nenet 49, 51 dhe 52 të tij.

Në mbyllje të afatit të pranimeve, sikurse e përcaktonte Udhëzimi nr. 25, dt. 27.10.2016, që ndryshoi për herë të fundit Udhëzimin nr. 13, të gjitha IAL-të e audituara rezultuan me kuota të paplotësuara, ndërkohë që kishte ende kërkesa për pranim nga ana e aplikantëve që rezultonin fitues. Në intervistat e realizuara me titullarët e IAL-ve dhe njërive kryesore të tyre, argumenti kryesor për mosregjistrimin e kandidatëve fitues pas datës kufi, është mbyllja e platformës online nga ana e RASH-it dhe detyrimi për të zbatuar Udhëzimin e titullarit të MAS. Në intervistën e zhvilluar në fazën studimore me titullaren e MAS-it, pyetjes së grupit auditues se “Çfarë i pengoi IAL-të publike të vazhdonin me pranimet pas datës 01.11.2016”, titullarja u shpreh: “Nuk i pengoi asgjë, sepse IAL-të e kishin mundësinë të vazhdonin me procesin e pranimeve.”. Një qëndrim i tillë konfirmohet edhe nga pranimet që IAL-të jopublike vazhduan të bënin edhe përtej dt. 01.11.2016, përcaktuar si afati përfundimtar i regjistrimeve me Udhëzimin nr. 13, të ndryshuar.

## **Konkluzione**

Për sa më lart:

- a) Me mosveprimet e tyre në kohën e duhur, të gjitha IAL-të e marra nën auditim, hoqën dorë nga përgjegjësitë që iu cakton Ligji në procesin e pranimit të aplikantëve, duke mos kundërshtuar një Udhëzim që futej në kompetencat e tyre.
- b) Senatet Akadematike dhe Bordet e Administrimit të IAL-ve janë përgjegjëse për moshartimin dhe mosmiratimin në kohë të Statutit dhe Rregullores së tyre, në bazë të afateve të përcaktuara nga Ligji.
- c) Përveç UT, Rektorët dhe Senatet Akadematike të IAL-ve e tjera të audituara kanë përzgjedhur në mënyrë joligjore RASH-in për të realizuar procesin e përllogaritjes së pikëve dhe rankimin e kandidatëve për studentë.
- d) Titullarët e IAL-ve publike dhe njërive kryesore të tyre që nuk regjistruan aplikantët fitues pas datës 1 nëntor 2016, shkelën ligjin duke respektuar një akt nënligjor, të cilin nuk e respektoi në fund të procesit as vetë institucioni (MAS) që e emetoi. Ndër këta titullarë, spikat rasti i Rektorit të UT-së, i cili edhe pse ka një korrespondencë të dendur me Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, ku ky i fundit i kërkon në mënyrë të përsëritur të përcjellë në AKP, 25 aplikantë të pranuar konform kriterëve në dt. 01.11.2016, por pas orarit zyrtar të mbylljes së platformës online, e refuzon vazhdimisht një kërkesë të tillë. Në intervistën e zhvilluar me Rektorin e UT, pyetjes së grupit auditues se: “A pati aplikantë të cilët dëshironin të regjistroheshin në IAL-në Tuaj pas afatit të përcaktuar nga MAS me Udhëzimin nr. 13, të ndryshuar?”, Rektori i është përgjigjur “Nga asnjë fakultet nuk pati kërkesa zyrtare për të regjistruar kandidatë për pranime, pas afatit të caktuar në udhëzim. Pati vetëm një rast të përcjellë nga Filiali i Sarandës, të cilën e përcollëm në AKP, por AKP refuzoi regjistrimin e kandidateve fituese për shkak se ka kaluar afati i vendosur në Udhëzimin nr. 13 dhe se regjistrimet online në raundin e dytë, nuk janë në administrimin e AKP-së”. Një qëndrim i tillë nga AKP, për pranimin e një kandidateje fituese nga kjo IAL publike është në kontrast të fortë me pranimin, regjistrimin dhe matrikullimin e 796 kërkesave që ky institucion pranoi nga IAL-të jopublike edhe një muaj pas dt. 01.11.2016, me propozim të Sekretarit të Përgjithshëm të MAS, në mbështetje të grupeve të punës që ky i fundit ngriti për këtë qëllim. Po ashtu, Rektori pohon në intervistë se ka patur edhe 4



kërkesa nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, por këto nuk i ka përcjellë në AKP, duke i kthyer vetë përgjigje Dekanit përkatës se: "... kanë kaluar të gjitha afatet dhe janë ezauruar procedurat e aplikimit". Në asnjë rast, nuk përmendet në intervistë, kërkesa për regjistrim në AKP e 25 kandidatëve fitues në FEUT, nga Dekani i këtij institucioni.

### **Rekomandime**

- a) Në përputhje me hierakinë e akteve normative të parashikuar në Kushtetutë, strukturat drejtuese të IAL-ve të njohin dhe respektojnë Udhëzimet dhe Urdhërat e MAS, specifikisht për procesin e pranimeve, vetëm nëse ato nuk bien në kundërshtim me Ligjin 80/2015.

**Gjithmonë**

- b) Senatet Akadematike dhe Bordet e Administrimit të IAL-ve, të hartojnë dhe miratojnë Statutet dhe Rregulloret e tyre në përputhje me Ligjin 80/2015 dhe praktikën e mira, duke specifikuar procedurat e tyre për procesin e pranimeve. Në këto dokumente, strukturat drejtuese të IAL-ve këshillohen të pasqyrojnë gjithashtu politikën apo strategjinë e tyre për kriteret dhe kuotat e pranimit, në mënyrë që t'iu mundësojnë aplikantëve profilizimin e duhur në arsimin e mesëm, si edhe për të shmangur ndryshimet arbitrare, të parashikuara apo nisur nga interesa të ngushta të këtyre filtrave pranues në arsimin e lartë.

**Sa më shpejt**

- c) Bordet e Administrimit dhe Administratorët e IAL-ve të ndjekin procedurat ligjore për shpalljen, lidhjen dhe ekzekutimin e kontratave të shërbimeve apo të tjera.

**Gjithmonë**

- d) MAS, në përputhje me funksionet e parashikuara nga Ligji 80/2015, specifikisht gërmat "e" dhe "ë" të nenit 7, të kontrollojë pajtueshmërinë e veprimtarisë së IAL-ve, që lidhën marrëveshje me RASH, me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, si edhe të auditojë përdorimin e fondeve publike që këto IAL angazhuan në këto marrëveshje.

**Deri në Dhjetor 2017**

- e) Rektori i UT të përcjellë në QSHA për pajisjen me nr. matrikullimi, listën e 25 kandidatëve fitues të pranuar dhe regjistruar konform Ligjit dhe kriterëve nga Fakulteti i Ekonomisë të kësaj IAL-je. Rektori i UT-së të kërkojë gjithashtu nga MAS kontrollin e ligjshmërisë së pranimit të këtyre aplikantëve nga FEUT.<sup>6</sup>

**Menjëherë**

**Për pyetjen: A rezultuan shpenzime të panevojshme financiare gjatë procesit të pranimit në IAL të maturantëve për vitin akademik 2016-2017?**

#### **1. AKP**

AKP u përfshi vetëm në procesin e aplikimeve dhe regjistrimeve finale e pasjisjes me nr. matrikullimi të pranimit në IAL të maturës 2016. Në evidencat e grumbulluara nga ky institucion, spikat shkresa nr. prot. 255/1 dhe dt. 12.02.2016, ku grupi i punës së ngritur nga Drejtoresha e Përgjithshme e këtij institucioni, me fokus "Koordinimin e procesit të aplikimeve në IAL", shprehet se: "Nëse rankimi i maturantëve/kandidatëve që kanë aplikuar në IAL-të publike kërkohet të kryhet nga AKP-ja, kjo do të ishte e pamundur të realizohej. IAL-të

---

<sup>6</sup> Fjalja e fundit është shtuar në refleksion të observacionit nr. 9, aneksi 2, gërma "a", "Observacionet e UT" dhe observacionit nr. 1, aneksi 3, gërma "b", "Observacionet e AKP-së".

publike kanë vendosur kritere të veçanta për çdo program studimi dhe softi ekzistues i Maturës Shtetërore që përdor AKP-ja nuk mund ta kryejë një proces të tillë”.

Me Urdhërin nr. 198, dt. 25.04.2016 dhe nr. prot. 4329 të titullares së MAS, ngrihet një grup pune me Kryetar Drejtoreshën e Përgjithshme të AKP-së dhe me fokus “Përgatitjen e platformës digjitale për aplikimet për pranimet në universitet për vitin akademik 2016-2017”. Në intervistën e kryer me titullaren e AKP-së, në fazën studimore të auditimit, konfirmohet se AKP ka qenë e angazhuar edhe në të kaluarën me procesin e aplikimeve, madje kur këto aplikime ishin të renditura edhe sipas prioritetit të aplikantit. Në këto kushte, është e paqartë çfarë synonte urdhëri nr. 198, dt. 25.04.2016 i MAS që ngre një grup pune për ndërtimin e platformës digjitale për aplikimet, ndërkohë që për aplikimet platforma ekzistonte dhe në shkresën 255/1, dt. 12.02.2016, shqetësimi i grupit të punës të AKP-së adreson rankimin, pra përlllogaritjen e pikëve dhe jo aplikimin. Fokusi i Urdhërit 198, dt. 25.04.2016 i MAS, bëhet ende edhe më i paqartë, kur në intervistën që grupi i auditimit zhvilloi me drejtorin ekzekutiv të RASH, pyetjes se: “Cila është baza ligjore e përfshirjes së RASH në procesin e pranimeve 2016”, titullari i RASH përgjigjet: “Urdhëri nr. 198, dt. 25.04.2016 i Ministrisë të Arsimit dhe Sportit, me anë të të cilit RASH ngarkohet të përgatisë platformën digjitale për pranimet në universitete për vitin akademik 2016-2017...”.

Nëpërmjet një marrëveshje<sup>7</sup> bashkëpunimi, AKP-ja transferoi bazën e të dhënave të kandidatëve për studentë tek RASH. Marrëveshja u iniciua nga Ministria e Arsimit dhe Sportit<sup>8</sup>. Në procesin e pranimeve, AKP, ndonëse Ligji 80/2015 nuk e njeh, u përpoq të jepte kontributin e saj korrekt, ndonëse ky institucion pranoi kërkesa për regjistrim pas datës së specifikuar në Udhëzimin nr. 13 dhe pas fillimit të vitit të ri akademik 2016-2017, duke i matrikulluar ato dhe duke shkelur kështu Ligjin dhe aktin normativ të nxjerrë nga titullarja e MAS. Shpenzimet e saj financiare për procesin e aplikimeve vlerësohen normale, ndoshta më të ulëta edhe se vitet e kaluara.

## 2. RASH

Përfshirja e RASH në procesin e pranimeve të maturës 2016 shtrihet në dy drejtime dhe konkretisht e kronologjikisht:

- a) Programimin e platformës digjitale për kontrollin e përputhshmërisë së aplikimeve në Portalin e Maturës Shtetërore me renditjet që do të bënin IAL-të. Baza ligjore për këtë përfshirje është Urdhëri nr. 414, dt. 01.08.2016. Nga informacioni i mbledhur mbi kostot e ndërtimit të kësaj platforme, RASH gjeneroi për grupin e auditimit një dokument që e nxjerr shpenzimin total në masën 11.718.416 lekë. Ky shpenzim është detajuar nga RASH në shpenzime për personelin në masën 6.298.416, shpenzime amortizimi 5.000.000 lekë dhe blerje kompjuterash 420.000 lekë. Në terma të kohës, ngritja e platformës pretendohet të ketë zgjatur 5 muaj (Maj-Tetor 2016) dhe në terma të burimeve njerëzore pretendohet se janë përfshirë 14 persona në total. Meqënëse dokumenti i kostove që RASH vuri në dispozicion, nuk ishte një dokument autentik, grupi i punës kërkoi të dhëna shtesë, të cilat evidentuan diferenca të thella midis shpenzimeve të pretenduara dhe atyre faktike. Specifikisht: a) në dokumentin e dytë që detajon përlllogaritjen e amortizimit, financieri i RASH amortizon me normën mesatare 20% në vit të gjitha aktivet e trupëzuara të këtij institucioni; vlerën e nxjerrë e pjesëton me 12 muajt e vitit dhe rezultatin e përfutur e shumëzon me 3 muaj. Shumëzimi me 3 muaj nënkupton se ky është afati që ka zgjatur

---

<sup>7</sup> Marrëveshje nr. 16-282 prot., datë 29.08.2016, “Për përhapjen e të dhënave personale të kandidatëve për studentë në IAL për vitin akademik 2016-2017 nga AKP tek RASH”.

<sup>8</sup> Urdhër nr. 414, datë 01.08.2016, “Për programimin e platformës digjitale dhe kontrollin e përputhshmërisë së aplikimeve në portalin matura shtetërore me renditjen në institucionet e arsimit të lartë”.

ndërtimi i platformës, ndërkohë që në setin e parë të dokumenteve, ky afat specifikohet 5 muaj. Shuma e amortizimit që rezulton nga kjo llogaritje është 5.962.865,42 lekë, ndërkohë që në setin e parë të dokumenteve rezulton 5.000.000 lekë. Komenti për mospërputhjen e këtyre dy shifrave nga Drejtori i RASH ishte: "... 5.962.865,42 është propozuar të rumbullakoset në 5.000.000."!!! Kjo përlllogaritje e amortizimit që i ngarkohet projektit, nënkupton se i gjithë aktiviteti i RASH për këto 3 muaj ka qenë i angazhuar vetëm në ndërtimin e platformës digjitale për pranimet, ndërkohë që në dokumentin e aktiviteteve që RASH ka paraqitur për periudhën Mars-Dhjetor 2016 në setin e parë, parashikohen edhe 31 aktivitete të tjera që do të kryheshin nga ky institucion. Mesatarisht, amortizimi që duhet t'i ngarkohet platformës digjitale për pranimet duhet të ishte 1/32 e shumës totale të mësipërme; b) në shpenzimet për personelin, rezulton se në setin e parë të dokumenteve, një pjesë e mirë e stafit të angazhuar, ka punuar për disa muaj me 150% të kohës normale të punës (33 ditë pune në muaj ose 4 orë/ditë pune jashtë orarit, ose 60 orë pune/javë). Po kështu, shpenzimet e personelit i janë ngarkuar në muajt përkatës, totalisht projektit të platformës digjitale, pavarësisht se RASH kishte në plan të kryente edhe 31 aktivitete të tjera gjatë po së njëjtës periudhë. Në setin e dytë të dokumenteve, referuar listëpagesave zyrtare të personelit, konstatohet se për të gjithë periudhën që pretendohet se është ngritur platforma, pagesat e personelit dhe detyrimet e tatimit për to kanë qenë normale, për 100% të kohës së punës; c) kosto e kompjuterave të blerë për projektin e digjitalizimit i është ngarkuar totalisht këtij projekti, ndonëse projekti ka zgjatur vetëm 5 muaj dhe amortizimi i kompjuterave realizohet për 4 vjet sipas legjislacionit në fuqi.

Në intervistën me Drejtorin e RASH pohohet se: "MAS-it nuk u iu faturua asnjë kosto, meqenëse ajo kontribuon në buxhetin e qendrës."

- b) Programimin dhe administrimin e platformës digjitale për t'i ofruar IAL-ve publike e private të interesuara, shërbimin e përlllogaritjes së pikëve dhe rankimit të aplikantëve kundrejt tarifës 200 lekë/aplikant, sikurse specifikohet në Vendimin nr. 1, dt. 29.08.2016, të KPD së RASH. Në përgjigjet e intervistës që RASH gjeneroi për KLSH, Drejtori i këtij institucioni pohon se e njëjta platformë që u programua në zbatim të Urdhërit 414 me fokus kontrollin e përputhshmërisë së aplikimeve me rankimet, u përdor edhe për zbatimin e Vendimit nr. 1 me fokus shitjen e shërbimit për përlllogaritjen e pikëve të maturanëve tek IAL-të e interesuara. Rrjedhimisht, zbatimi i këtij vendimi nuk u shoqërua me kosto shtesë, por me të ardhura për këtë institucion, sepse RASH ia shiti këtë shërbim 5 IAL-ve publike, për një vlerë totale 6.142.400 lekë. Kontratë-marrëveshjet që i sollën RASH këto të ardhura u lidhën në harkun kohor të 2-3 ditëve nga momenti kur KPD mori Vendimin nr. 1, pa kaluar në asnjë procedurë prokurimi apo përgjithësisht konkurrimi.

Në intervistën e zhvilluar me Drejtorin e RASH pohohet se: "... u parashikua që 55-60% e koston së platformës do të mbulohej nga Universitetet, ...". Një pohim i tillë, shoqëruar me kontraktimin e shpejtë dhe pa procedura konkurruese të RASH-it nga IAL-të, hedh dyshime mbi qëllimin e vërtetë të programimit të platformës, sepse kjo platformë u krijua për kontrollin nga ana e MAS të përputhshmërisë së aplikimeve me rankimet që bënë IAL-të dhe jo për t'ia shitur procesin përlllogaritës IAL-ve.

### 3. IAL-të

IAL-të e audituara, nga pikëpamja e shpenzimeve financiare të kryera në procesin e pranimit, ndahen në dy grupe: a) UT, dhe b) gjithë të tjerat (UMT, UD, UV, UE, USH).

- a) UT e kreu vetë procesin përlllogaritës dhe rankues për të dyja raundet në fakultetet e tij. Nga intervistat e realizuara me Rektoren dhe titullarët e njëjësive kryesore, pohohet se UT e priste fillimisht nga AKP të kryente përlllogaritjen e pikëve dhe t'ia përcillte atë UT-së, sëbashku

me të dhënat e tjera që Udhëzimi 13 i specifikonte që duheshin përcjellë në dt. 30.08.2016. Pika 10, Kreu II i këtij udhëzimi e linte evazive nëse të dhënat që AKP duhet t'i përcillte IAL-ve, do të përfshinin ose jo edhe pikët për secilin aplikant. Të gjendur të papërgatitur dhe në kushtet kur listat e para të fituesve duheshin shpallur në dt. 05.09.2016, Rektori i UT, në dt. 31.08.2016 merr Vendimin nr. 1 për ngritjen e grupit të punës i cili do ta realizonte procesin e përlogaritjes dhe rankimit. Në intervistën e zhvilluar me Dekanin e Fakultetit të Shkencave Natyrore të kësaj IAL-je pohohet se grupet e punës u ngritën në nivel Rektori (5 persona) dhe në nivel Fakulteti (4-5 persona për grup) për një total prej 28 personash. Këto grupe pune punuan mbi aplikacione të gatshme (Excel dhe SQL) dhe kontrolluan njëri-tjetrin për përputhshmërinë e rezultateve. Pikët arritën të përlogariteshin, maturantët të rankoheshin dhe listat të shpalleshin në afat, pa u kontestuar nga aplikantët e interesuar për saktësinë e llogaritjeve. Për punën e kryer, grupet e ngritura ende nuk janë paguar nga Ministria e Financës, ndonëse UT ia ka bërë prezente disa herë kërkesën për kalimin e pagesës. Rrjedhimisht, ky proces u realizua pa shpenzime financiare (as të konstatuara dhe as të paguara) në këtë IAL.

b) Universiteti i Mjekësisë, Universiteti i Shkodrës, Universiteti i Durrësit, Universiteti i Elbasanit dhe Universiteti i Vlorës e kryen procesin përlogaritës dhe rankues, duke kontraktuar RASH.

c) Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali", bazuar në Vendimin e Senatit Akademik nr. 30, dt. 01.09.2016, ka lidhur marrëveshje<sup>9</sup> me RASH më datë 02.09.2016 për realizimin e renditjes së kandidatëve për studentë. Pas paraqitjes së faturës së arkëtimit nr. 3, dt. 15.09.2016, nga ana e Universitetit është bërë pagesa për RASH me urdhrin e shpenzimit nr. 321, dt. 19.12.2016, në vlerën 657.400 lekë, urdhëruar nga Administratori i IAL-së.

Nga ana e Universitetit të Vlorës nuk është ndjekur asnjë procedurë ligjore në lidhje me marrjen në dorëzim të këtij shërbimi dhe vlerësimin e saktësisë së faturës së arkëtimit, në kundërshtim me Ligjin MFK dhe Udhëzimin nr. 30. Gjatë kontrollit të numrit të aplikantëve pranë këtij universiteti, grupi i auditimit kërkoi informacion zyrtar pranë AKP-së, e cila në përgjigjen e saj me shkresën nr. 941/3, dt. 16.05.2017 jep të dhëna që konfirmojnë se Universiteti i Vlorës ka paguar 73.400 lekë më shumë në favor të RASH.

Në Universitetin e Vlorës kanë aplikuar për raundin e parë 2.061 kandidatë për studentë dhe në raundin e dytë 1.958, bazuar në shkresën e AKP dhe, po sipas konfirmimit të AKP-së, gjatë raundit të parë dhe të dytë, aplikantët që kanë aplikuar në të dy raundet sëbashku, duke u numëruar vetëm njëherë sipas ID-së, janë 2.920 kandidatë për studentë. Bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit me RASH, Universiteti i Vlorës ka pranuar, pa ushtruar kontrollin e saktësisë së faturës së arkëtimit, vlerën e propozuar nga RASH për 3.287 aplikantë. Sipas rivlerësimit të bërë nga grupi i auditimit, Universiteti i Vlorës i detyrohej RASH vlerën 584.000 lekë në përputhje me të dhënat e AKP-së dhe jo vlerën 657.400 lekë që pretendon RASH.

## **Konkluzione**

Për sa më lart:

- a) Programimi i platformës digjitale në zbatim të Urdhërit 414, dt. 01.08.2016 është i pajustificuar financiarisht. Për këtë platformë nuk është bërë një planifikim apo preventiv shpenzimesh nga ana e RASH. Dokumentet mbi shpenzimet që RASH vuri në dispozicion të KLSH-së janë fryrë artificialisht dhe qëllimisht.
- b) MAS nuk kishte arsye të porosiste programimin e një platforme kaq të kushtueshme,

---

<sup>9</sup> Marrëveshja nr. 1165 prot, dt. 02.09.2016 "Për ofrimin e platformës digjitale për maturën shtetërore për vitin akademik 2016-2017."

për një proces kontrolli që mund të realizohet fare mirë në aplikacione të gatshme, sikurse e kreu UT. Për më tepër, procesi i kontrollit që kreu RASH për IAL-të të cilat nuk e kontraktuan, u realizua me kampionim, pra jo për të gjithë aplikantët.<sup>10</sup> Kampioni rastësor për UT-në<sup>11</sup> që mbledhi RASH, përllogaritet në 5% të popullatës në raundin e parë dhe 1% për raundin e dytë.<sup>12</sup> Përtej faktit që statistikisht, një proces i tillë kontrolli rezulton joefektiv<sup>13</sup>, kontrolli për një numër të tillë të dhënash realizohet fare lehtë në Microsoft Excel apo programe të ngjashme.

- c) Grupi i punës ka dyshime të arsyeshme se ndryshimi i destinacionit të platformës digjitale me Vendimin nr. 1 të KPD-së, ka qenë qëllimi i vërtetë për programimin e saj. Në këtë kontekst merr kuptim edhe fryrja artificiale e shpenzimeve nga ana e RASH.
- d) Përveç UT-së, të gjitha IAL-të e marra nën auditim kanë dëmtuar financiarisht buxhetet e tyre, duke kryer shpenzime të jashtëligjshme, të paparashikuara dhe të panevojshme në procesin e pranimeve. Përgjegjësinë për këtë dëm financiar e kanë Rektorët e këtyre IAL-ve.
- e) Universiteti i Vlorës është mbifaturuar nga RASH për shërbimin e kryer në vlerën 73.400 lekë. Ky mbifaturim i paguar është dëshmi e mungesës së kontrollit që zyra e financës së kësaj IAL-je duhet t'i kishte bërë faturës së pretenduar nga RASH. Përgjegjësinë për këtë mbifaturim të paguar e ka financieri dhe administratori i këtij universiteti.
- f) UT përfaqëson një praktikë të mirë në aspektin e ekonomicitetit të pranimeve, të cilën KLSH e vlerëson dhe e inkurajon si shembull për IAL-të e tjera publike.

## **Rekomandime**

Për sa më lart:

- a) MAS të bëjë auditimin e aktivitetit financiar të RASH për vitin 2016.

**Deri në fund të vitit 2017**

- b) Bordet e Administrimit dhe Administratorët e IAL-ve të cilat kanë kontraktuar RASH-in në procesin e pranimeve 2016, të ndjekin rrugët ligjore për të rikuperuar plotësisht ose pjesërisht dëmin e shkaktuar.

**Në vijimësi**

- c) IAL-të publike të ndjekin rrugët ligjore për ekonomizimin e kontraktimit të shërbimeve të tilla në procesin e pranimet, sikurse në të gjitha aktivitetet me efekte financiare të tyre. KLSH këshillon IAL-të me departamente informatike që të aftësojnë burimet e tyre njerëzore për të përdorur aplikacionet e gatshme në raste të tilla.

**Gjithmonë**

---

<sup>10</sup> Evidentuar me memon e dt. 08.09.2016, që Drejtori i RASH përcjell tek Ministri i MAS, "Raport për kontrollin e aplikimeve për raundin e parë, sipas Urdhërit nr. 414, dt. 01.08.2016" dhe memon e dt. 10.10.2016, "Raport për kontrollin e aplikimeve për raundin e dytë, sipas Urdhërit nr. 414, dt. 01.08.2016".

<sup>11</sup> E vetmja IAL e pakontraktuar nga RASH nga IAL-të nën auditim.

<sup>12</sup> 65 aplikantë të kontrolluar për raundin e parë kundrejt 88.276 që aplikuan dhe 1.306 që u pranuan në UT, dhe 39 aplikantë të kontrolluar, kundrejt 56.916 që aplikuan dhe 3.597 që u pranuan në raundin e dytë. Shkëputur këto të dhëna nga memot e mësipërme që Drejtori i RASH i ka përcjellë titullares së MAS.

<sup>13</sup> Me një nivel besimi 95% dhe marzh gabimi 5, RASH duhet të kishte përfshirë në kampion 300 aplikantë në raundin e parë (~23% të popullatës) dhe 350 në raundin e dytë (~10% të popullatës). Këto vlera i referohen kampionimit kundrejt aplikantëve fitues, sepse nëse do të ishte bërë kontrolli për të gjithë listat e aplikantëve, jo vetëm të fituesve, RASH duhet të kishte verifikuar edhe më shumë kandidatë në secilin raund, vetëm për këtë IAL.

- d) Shuma prej 73.400 lekë duhet t'i kthehet Universitetit të Vlorës në llogarinë e vet në degën e thesarit, pasi është përfituar në mënyrë të padrejtë nga RASH.

**Menjëherë**

- e) Bordi i Administrimit dhe Administratori i UT-së të marrin masat e nevojshme për të paguar grupet e punës që realizuan përlllogaritjen e pikëve dhe rankimin në pranimet e vitit 2016.

**Menjëherë**

**Për pyetjen: A u shpërdorua koha dhe burimet njerëzore në procesin e pranimeve për vitin akademik 2016-2017?**

Në terma kohorë, sikurse u tregua edhe në skemën 4 më lart, procesi nisi në muajin janar të 2016, me shpalljen e kriterëve nga IAL-të dhe depozitimim të tyre në MAS dhe përfundoi zyrtarisht më 01.11.2016, me mbylljen e regjistrimeve.<sup>14</sup> Ndonëse, koha në dispozicion ishte e mjaftueshme, IAL-të publike nuk depozituan kriterë të qarta dhe të mbështetura në kurrikulën parauniversitare, gjë e cila u konstatua me kontestimet që këto kriterë patën më pas nga maturantët dhe ndryshimin e tyre më shumë se një herë nga një pjesë e IAL-ve apo njërive kryesore brenda tyre. Udhëzimi nr. 13 specifikonte që maturantët mund të fillonin të aplikojnë për raundin e parë të pranimeve në intervalin 01-11 Gusht, pra afërsisht 2 muaj përpara fillimit të vitit të ri akademik. Vende të tjera të zhvilluara, e nisnin procesin e aplikimit të maturantëve ende pa mbaruar viti i fundit i arsimit të mesëm, duke variuar nga 12 muaj përpara në rastin e UK apo Hollandës, deri në 6 muaj apo më shumë në rastin e Gjermanisë, në varësi kjo edhe të sistemit të aplikimeve, ku disa vende e kanë opsionalisht të centralizuar këtë sistem, ndërsa disa të tjera e kanë direkt të lidhur me universitetin ku është i interesuar aplikanti (tërësisht të decentralizuar). Udhëzimi 13 parashikonte që fituesit e raundit të parë të shpallehin nga IAL-të në dt. 05.09.2016, 5 ditë pasi AKP iu kishte përcjellë këtyre IAL-ve listat e aplikantëve të interesuar, në të cilat nuk përfshiheshin pikët e përlllogaritura për secilin aplikant. Më pas, Udhëzimi linte edhe 5 ditë të tjera për procesin e ankimit, ku listat përfundimtare duheshin shpallur nga IAL-të në dt. 11.09.2016. Në intervalin 13-20.09, Udhëzimi lejonte aplikantët fitues të regjistroheshin në degën e preferuar. Të gjitha listat apo dokumentet e raundit të parë dërgoheshin në AKP elektronikisht (me CD, DVD, etj). E njëjta procedurë udhëzohej të kryhej edhe në raundin e dytë, ku: riaplikimet duheshin bërë në periudhën 23.09-01.10, AKP përcillte tek IAL-të listat e aplikantëve të interesuar në 04.10, IAL-të shpallnin listat provizore më dt. 07.10 dhe ato përfundimtare më dt. 12.10. Regjistrimi i fituesve mund të bëhej deri më dt. 16.10. Më pas, në Udhëzimin fillestar parashikohej që regjistrimet e mëtejshme të bëheshin në periudhën 16-20.10. Në Udhëzimin nr. 24, që plotësoi Udhëzimin nr 13 u bë ndarja në faza 48-orëshe brenda këtij intervali, ndërsa me Udhëzimin nr. 24/1, afati i regjistrimit me këto faza 48-orëshe u shty deri më dt. 27.10. Me Udhëzimin nr. 25, afati i fundit u shty sërish deri më 01.11.2016. Me Urdhërat e nxjerrë nga Sekretari i Përgjithshëm i MAS, pranimet dhe regjistrimet në IAL-të jopublike, vijuan të bëheshin edhe pas datës së specifikuar në Udhëzim, ku korrespondencat me Drejtoreshën e Përgjithshme të AKP-së shtrihen deri në muajt të parë të 2017-s., pra pasi kishte nisur viti i ri akademik.

Nga pikëpamja e burimeve njerëzore, në proces u përfshinë një numër i madh personeli nga të gjitha subjektet e audituara, që nga titullarët e institucioneve e deri tek specialistët e tyre.

---

<sup>14</sup> IAL-të jopublike vazhduan me regjistrimet edhe përtej këtij afati. Afati më i fundit që dokumentohet nga grupi i punës është muaji Mars 2017.

## Konkluzione

Për sa më lart:

- a) MAS dhe IAL shpërdoruan në mënyrë flagrante kohën dhe burimet njerëzore që kishin në dispozicion, duke mos përgatitur në afatet ligjore, aktet normative, statutet dhe rregulloret që do të rregullonin procesin e pranimeve specifiku dhe aspektet e tjera të aktivitetit të tyre, në përgjithësi.
- b) IAL-të shpërdoruan kohën dhe burimet njerëzore në dispozicion, duke mos u njohur me kujdes dhe në kohën e duhur me kurrikulën parauniversitare; duke përcaktuar kritere të paqarta dhe që nuk mund të konvertoheshin në formula përlllogaritëse, duke mos informuar në kohë maturanët dhe marrë prej tyre *feedback*-un e nevojshëm. Shpërdorimi i kohës dhe njerëzve nga IAL-të e ka burimin në pasivitetin e tyre për të mos marrë përsipër detyrimet ligjore dhe përgjegjësitë morale ndaj maturanëve dhe shoqërisë në përgjithësi.
- c) MAS alokoi në mënyrë të gabuar kohën dhe burimet njerëzore midis procesit të aplikimit, pranimit dhe regjistrimit. Procesi i aplikimeve duhet të kishte nisur më herët në kohë, sikurse e realizojnë vendet e tjera të zhvilluara. Një proces më i hershëm aplikimi do të ndihmonte IAL-të të përcaktonin më realisht kuotat e tyre dhe të aplikonin filtra shtesë pranimi, sikurse do iu kishte dhënë mundësi aplikantëve të njihnin më herët konkurrencën në degët e preferuara dhe të aplikonin zgjuar, duke rritur shanset e tyre për sukses. Në procesin e pranimit MAS angazhoi AKP-në dhe RASH, një angazhim jo vetëm i pavlefshëm nga pikëpamja ligjore, por edhe i panevojshëm, sepse ky proces mund dhe duhej të kryhej tërësisht nga vetë IAL-të. Në procesin e regjistrimit, MAS lejoi që të shkeleshin afatet e Udhëzimit 13 nga IAL-të jopublike dhe AKP, duke vijuar me ngritjen e grupeve të punës që do të vlerësonin aplikantët pas dt. 01.11.2016, proces i cili zgjati deri në Mars të 2017-s. Mundësia e këtyre regjistrimeve pas datës kufi nga ana e MAS nuk u bë publike dhe as iu njoftua IAL-ve publike të interesuara. Shpërdorimi i kohës dhe burimeve njerëzore nga ana e MAS e ka burimin në mbiangazhimin e saj dhe strukturave në varësi për të centralizuar procesin e pranimeve.
- d) Me Udhëzimin që nxorri, MAS alokoi në mënyrë të gabuar kohën për regjistrimin e fituesve specifiku për raundin e parë të pranimeve. Ky afat i gjatë, përveçse ishte i tepërt, shkaktoi panik tek maturanët, humbje të besimit tek procesi dhe deformoi parimin meritë-preferencë në këtë raund, sikurse trajtohet në pyetjen audituese që adreson efektivitetin e procesit.
- e) Udhëzimi i MAS krijoi një emergjencë artificiale të procesit të pranimit, e cila evidentohet qartë me ndryshimin e vazhdueshëm të afateve të regjistrimit nga Udhëzimet që pasuan atë nr. 13 dhe që kulmoi me shkeljen nga vetë MAS të afatit përfundimtar, datës 01.11.2016, duke mos nxjerrë më Udhëzime të Titullarit, por Urdhëra të Sekretarit të Përgjithshëm të këtij institucioni. Kjo emergjencë artificiale shkaktoi stres të panevojshëm tek punonjësit e institucioneve të përfshira, sikurse edhe tek maturanët e familjet e tyre.

## Rekomandime

Lidhur më këtë çështje audituese, KLSH rekomandon:

- a) MAS ta hapë procesin e aplikimeve për në IAL, përmes QSHA-së, më herët në kohë, në përputhje me eksperiencat botërore.

**Në vijimësi**

- b) MAS të shfuqizojë Udhëzimin nr, 15, dt. 19.05.2017, “Për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit ..., për vitin akademik 2017-2018”, sepse ekziston risku potencial që të përsëriten gabimet e vitit të kaluar, duke dëmtuar ekonomicitetin e procesit.

**Menjëherë**

- c) IAL-të të planifikojnë procesin e pranimit, ngrenë komisione pranimi dhe marrin të gjitha masat e nevojshme për të realizuar pranimin e maturantëve përpara datës së nisjes së vitit të ri akademik, specifikuar nga Ministri përgjegjës për arsimin në përputhje me Ligjin 80/2015.

**Vazhdimisht**

### **A ofroi procesi output-in e synuar?**

Problematikat e identifikuara për secilën palë, në optikën e KLSH-së, jepen si më poshtë:

#### 1. IAL-të

##### *a) Output-i sasior*

Të gjitha IAL-të e marra nën auditim rezultuan me kuota të paplotësuara në mbyllje të afatit të regjistrimeve, ndonëse kishte ende kërkesa për regjistrim. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet numri i kërkesave dhe regjistrimeve sipas rraundeve, duke evidentuar edhe kuotat e paplotësuara, për secilën IAL të audituar.

Në krahasim me vitet e kaluara, numri i kuotave të paplotësuara rezulton më i lartë. Po kështu, intervistat me titullarët e IAL-ve konfirmojnë mbetjen e vendeve bosh në degë të cilat historikisht janë plotësuar 100% dhe kanë qenë shumë të preferuara. Ky mosplotësim kuotash rezulton në të ardhura të munguara për këto IAL, sikurse në një kosto shtesë për krejt shoqërinë. Konkretisht, ndonëse Rektorëve të IAL-ve iu kërkua informacioni mbi numrin e saktë të maturantëve që donin të regjistroheshin në IAL-të e tyre pas afatit përfundimtar dt. 01.11.2016, ata konfirmuan se ka patur maturantë në listë pritjeje, por nuk mund të përcaktonin numrin e saktë të tyre. Nga të dhënat që grupi i auditimit mori në AKP, rezulton se pas datës 01.11.2016, me Urdhërat e lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm i MAS, janë pranuar dhe regjistruar në IAL jopublike 796 maturantë.<sup>15</sup> Nëse IAL-të publike do të kishin vijuar me regjistrimin e aplikantëve edhe pas afatit kufi të përcaktuar në Udhëzimin nr. 13, sikurse bënë IAL-të jopublike dhe, duke e ndarë numrin e mësipërm në mënyrë të barabartë midis aplikantëve që do regjistroheshin në IAL-publike me ato jopublike, rezulton se me një tarifë mesatare vjetore shkollimi prej afro 200 euro në IAL-të publike, e ardhura e munguar potenciale e këtyre IAL-ve rezulton  $398 \text{ aplikantë} \times 200 \text{ euro} = 79.600 \text{ euro}$  ose afro 10.746.000 lekë në vit. Për tri vitet e studimeve Bachelor, kjo shumë mund të arrinte afërsisht deri në 32.238.000 lekë.

Nga ana tjetër, duke marrë një tarifë mesatare shkollimi në IAL-të jopublike prej 1.700 euro/vit, shoqërisë në tërësi, pasiviteti i IAL-ve publike për mos të evidentuar, ndjekur dhe regjistruar aplikantët që kërkonin të pranoheshin në to pas dt. 01.11.2016, mund t'i ketë kushtuar deri në  $(1.700 - 200) \times 398 = 597.000 \text{ euro/vit}$ , ose 80.595.000 lekë/vit, ose 241.785.000 lekë për krejt periudhën e studimeve të Bachelor-it. Në këtë mes, më të penalizuarit rezultojnë aplikantët me rezultate të mira dhe që vijnë nga familje me të ardhura të ulta apo edhe mesatare.

##### *b) Output-i cilësor*

---

<sup>15</sup> Ky numër mund të jetë edhe më i lartë, por deri në momentin e hartimit të këtij raporti, grupi auditues kaq arriti të konfirmojë, pa u kontestuar, nga AKP.



Nga intervistat e zhvilluara me drejtuesit e njëjësive kryesore të IAL-ve publike rezultojnë përgjigje të larmishme lidhur me këtë çështje. Për shembull, duke iu referuar Universitetit të Tiranës, si IAL-ja publike më e madhe në vend e më e preferuara ndër to dhe jo vetëm, Dekani i Fakultetit të Ekonomisë shprehet i shqetësuar për faktin se në këtë fakultet ka rënë cilësia e aplikantëve të pranuar në vitin 2016-2017, shprehur në terma të notës mesatare. Për degë të preferuara, siç është rasti i degës Financë, ndryshe nga vitet e kaluara ku vinin maturantë me nota mesatare mbi 9 (nëntë), këtë vit ishin pranuar edhe maturantë me mesatare midis 6 (gjashtë) dhe 7 (shtatë). Nga intervista me Dekanen e Fakultetit Histori-Filologji, rezulton se maturantët e pranuar të këtij viti kishin mesatare më të lartë se vitet e kaluara, kjo edhe si pasojë e faktit që në raundin e parë, shumë maturantë zgjodhën degët ku rezultuan fitues, pavarësisht se nuk i kishin preferenca prioritare. Dekanët e Fakulteteve të tjera u shprehën se mund të ketë një rënie të lehtë të mesatares së aplikantëve të pranuar, por kjo nuk paraqitet shqetësuese dhe se maturantët me rezultate të larta ende preferojnë dhe pranohen në Fakultetet e UT-së.

Parametri i përdorur për të vlerësuar cilësinë e maturantëve të regjistruar në IAL-të publike, si tregues i eficiencës së procesit të pranimeve, nga të gjithë titullarët e intervistuar vijon të mbetet mesatarja, ndonëse grupi i auditimit ka dyshime të arsyeshme se mesatarja nuk përfaqëson një parametër tërësisht të besueshëm në kushtet kur arsimi i mesëm në Shqipëri karakterizohet nga diferenca në vlerësim midis atij publik dhe privat, apo edhe midis atij publik që ofrohet në zona e qytete të ndryshme të vendit.

## **Konkluzione**

Për sa më lart:

- a) IAL-të publike nuk disponojnë parametra vlerësues të performancës së tyre lidhur me procesin e pranimeve specifiku, por edhe gjurmimit të progresit të studentëve gjatë dhe pas kryerjes së studimeve. Pavarësisht shqetësimit të maturantëve dhe problemeve të konstatuara në pranimet e vitit akademik 2016-2017, asnjë nga IAL-të e audituara nuk ka bërë një analizë rigoroze të shkaqeve të këtyre problematikave dhe rrugëve të zgjidhjes së tyre.
- b) Procesi i pranimet të maturantëve në vitin akademik 2016-2017 i kushtoi IAL-ve, maturantëve dhe shoqërisë në përgjithësi, shuma monetare të panevojshme për t'u shpenzuar apo që mund të shpenzoheshin më me eficiencë në drejtime të tjera. Të ardhurat e munguara që IAL-të publike nuk realizuan për shkak të pasivitetit të tyre, do të ndikojnë negativisht buxhetet e këtyre institucioneve dhe do të pengojnë rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe konkurrueshmërinë e tyre në fushën e arsimit të lartë, sikurse edhe arritjen e objektivave të tjera.
- c) Udhëzimi nr. 13 dhe Urdhërat që e pasuan atë rritën si mesatare dhe në total koston e arsimimit të lartë për vitin akademik 2016-2017, duke bërë një rishpërndarje të maturantëve fitues drejt IAL-ve jopublike pas afatit kufi, dt. 01.11.2016. Në terma të cilësisë, problemi paraqitet kompleks dhe KLSH rezervohet të japë një opinion mbështetur në evidencat e mbledhura nga IAL-të publike dhe pamundësisë për të marrë informacion nga IAL-të jopublike.
- d) Në procesin e pranimeve, mesatares i vihet një rëndësi e madhe nga MAS, IAL-të dhe më pak nga maturantët. KLSH gjykon se mesatarja, si filtri i vetëm i përdorur nga IAL-të e marra nën auditim, është një parametër jo tërësisht i besueshëm, i pamjaftueshëm dhe në disa raste edhe deformues i kapacitetit intelektual dhe prirjeve të maturantit që kërkon të ndjekë arsimin e lartë publik në Shqipëri.

## **Rekomandime**

Për sa më lart:

- a) IAL-të të hartojnë, aplikojnë dhe përditësojnë parametra apo indikatorë të performancës së studentëve që pranohen, ndjekin dhe përfundojnë studimet në to. Këta indikatorë dhe vlerësimet e tyre për çdo vit të bëhen publike për të informuar të interesuarit mbi ecurinë e sektorit dhe aktorëve në të, sikurse edhe për të ndihmuar maturantët që të bëjnë zgjedhjen e përshtatshme kur aplikojnë për pranime në IAL.

**Në vijimësi dhe vazhdimisht**

- b) MAS të shfuqizojë Udhëzimin nr, 15, dt. 19.05.2017, “Për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit ..., për vitin akademik 2017-2018”, sepse ky Udhëzim mund të krijojë sërish probleme të panevojshme në plotësimin e kuotave të IAL-ve publike dhe, duke u pasuar nga Urdhëra jotransparentë, mund të dëmtojë buxhetet dhe performancën e IAL-ve publike, sikurse mund të rrisë kostot e arsimit të maturantëve dhe shoqërisë në përgjithësi. Ekziston risku potencial që ky udhëzim të dëmtojë sërish eficiencën e procesit.

**Menjëherë**

- c) IAL-të publike inkurajohen të përdorin filtra shtesë, krahas mesatares, në pranimet e maturantëve, të paktën për degët e preferuara më shumë. Këto filtra mund të huazohen nga praktikant dhe eksperiencat e mira të vendeve të tjera.

**Në vijimësi dhe vazhdimisht**

### **A ofroi procesi cilësinë e synuar në terma të saktësisë lidhur me përcaktimin e kriterëve dhe përlllogaritjen e fituesve?**

Procesi i pranimeve në universitete nga viti 2006-2015 është realizuar nga MAS nëpërmjet AKP-së, duke e vlerësuar maturën shtetërore si hyrëse. Ligji i Arsimit të Lartë parashikon rritje të autonomisë universitare, duke lejuar IAL-të që të realizojnë procesin e pranimeve për kandidatët për studentë, sipas kriterëve shtesë të vendosura prej tyre, duke e bërë maturën shtetërore dalëse. Për të fituar të drejtën e studimit, kandidati për student duhet të plotësojë dy kriterë: atë përjashtues të përcaktuar sipas VKM-së, por edhe kriterë të tjera të veçanta që kanë përcaktuar IAL-të, në zbatim të Ligjit nr. 80/2015<sup>16</sup>. Gjatë tremujorit të parë të vitit 2016, IAL-të shpallën kriteret e pranimet për kandidatët për studentë sipas programeve të tyre të studimit, njëkohësisht duke i dërguar tek AKP-ja dhe MAS-i.

### **Konkluzione**

- a) Kriteret e vendosura nga shumica e IAL-ve të audituara rezultuan të pastudiuara, të pambështetura në kurrikulën parauniversitare, jolehtësisht të konvertueshme në formula vlerësimi, ndryshuan disa herë dhe në mënyrë jotransparente për të interesuarit.
- b) Kriteret e vendosura nga IAL-të penalizuan në masë të konsiderueshme kandidatët për studentë në vitin akademik 2016-2017. Rreth 64% e të anketuarve, ku më shumë se gjysma e tyre rezultojnë fitues në raundin e parë të pranimeve, e konfirmojnë këtë konstatim.
- c) Përlllogaritja e pikëve të fituesve në IAL-të e audituara ishte përgjithësisht e saktë, me përjashtim të një rasti të izoluar në Universitetin e Elbasanit, i cili u korrektoi në kohën e duhur nga AKP, si edhe një praktike në Universitetin e Vlorës ku kriteret e vendosura

---

<sup>16</sup> Ligji nr. 80/2015, neni 3, pika 4/b; neni 4, pika 1; neni 23, pika 4; neni 25, pika 8; neni 38 pika 1/a dhe 3; neni 42, pika 7; neni 69, pika 3; neni 74, pika 2; neni 135.

nga kjo IAL u ndryshuan për arsye objektive.<sup>17</sup>

### Rekomandime

- a) IAL-të të marrin të gjitha masat e nevojshme për të përcaktuar kritere të qarta, të konvertueshme në formula transparente vlerësimi, të mbështetura në kurrikulën parauniversitare dhe të qëndrueshme në kohë. IAL-të këshillohen që politikën apo strategjinë e tyre të krijojnë përzgjedhëse për pranimet e maturantëve ta përfshijnë dhe publikojnë në Statutet, Rregulloret apo dokumentet e tjera strategjike të tyre.

**Në vijimësi dhe vazhdimisht**

- b) MAS të bëjë kontrollin e përputhshmërisë së kritereve me kurrikulën parauniversitare dhe t'i njoftojë IAL-të për mospërputhjet e mundshme dhe korrektimin e tyre në kohë, duke mos lejuar ndryshimin e kritereve pasi është hapur procesi i aplikimit në QSHA dhe deri në shpalljen e kritereve për vitin apo semestrin pasardhës akademik.

**Në vijimësi dhe vazhdimisht**

- c) IAL-të mund të përgatisin një aplikacion për t'iu ardhur në ndihmë maturantëve që të përlogarisin pikët përkatëse individuale në programet e studimit që ofrojnë. Ky aplikacion mund të hidhet online në faqet e tyre të Internetit dhe mirëmbahet vazhdimisht.

**Nëse e gjykojnë të arsyeshme dhe ekonomike**

**A u pranuan studentët në programin dhe IAL-në që preferonin, sipas meritës që dispononin?**

### Konkluzione

- a) Efektiviteti i procesit të pranimit, sikurse matet nga meritë-preferenca, e humbet vlerën dhe rëndësinë tij nëse palët e përfshira kanë informacion asimetrik apo rregullat e lojës ndryshojnë në momentin e fundit. Kriteret e paqarta nga IAL-të dhe ndryshimi jotransparent i tyre, i vlerësuan meritat e aplikantëve ndryshe nga sa aplikantët vlerësuan meritat e tyre dhe shprehën preferencat bazuar në to. Procesit i pranimit, nga një proces për të cilin maturantët kishin investuar në arsimin e mesëm dhe prisnin të shpërbleheshin për të, duke u pranuar në degën e preferuar, u kthye në një proces rastësor, ku disa u penalizuan rastësisht apo edhe padrejtësisht e disa përfituan në kurriz të të parëve. Grupi i auditimit, duke qenë i vetëdijshëm për kufizimet që pozon pyetësi si teknikë audituese në garantimin e besueshmërisë së konkluzioneve, konstaton se afro 43,3% e të anketuarve (ish-maturantë që nisën shkollën e lartë në 2016) nuk fituan në 3 preferencat e para që shprehën, në secilin prej rasteve të pranimit.
- b) Kombinuar me pikën (a) më lart, koha e gjatë që Udhëzimi nr. 13 akordoi për regjistrimin e fituesve të raundit të parë, shtyu një pjesë të aplikantëve (44% nga sondazhi i KLSH-së) që të regjistroheshin në degë joprioritare për ta. Sikurse është përmendur edhe në krye të këtij raporti, efekti *bottleneck* shkaktoi panik tek aplikantët në raundin e parë, duke sjellë humbjen e besimit tek procesi dhe duke vënë në pikëpyetje madje edhe efektivitetin e Ligjit të ri 80/2015, i cili përkundrazi, në këtë aspekt është më bashkëkohor dhe më afër praktikave të mira europiane që përdorin vende si: Anglia,

---

<sup>17</sup> Ndryshuar në raportin final, në reflektim të observacioneve 6 dhe 7, aneksi 3, gërma “c”, “Observacionet e RASH”, paraqitur më poshtë në këtë dokument.

Gjermania, etj, etj., sesa Ligji i vjetër nr. 9741, dt. 21.05.2007, ndryshuar.

- c) Efektiviteti nuk është një parametër që mund të arrihet shpejt apo menjëherë. Grupi i auditimit, duke qenë i vetëdijshëm për këtë fakt dhe duke ditur se pranimet në vitin akademik 2016-2017 ishin të parat që realizoheshin në kuadrin e Ligjit të Ri, konstaton se MAS dhe IAL-të e ezauruan dhe tejkaluan marzhin e tyre të gabimit. Ajo që është më e rëndësishmja, nisur nga nxjerrja e Udhëzimit nr. 15 të MAS për vitin akademik 2017-2018 dhe mungesa e analizave nga ana e IAL-ve për të reflektuar rigorozisht gabimet e vitit të shkuar, është se efektiviteti i procesit të pranimit mbetet ende i riskuar dhe i paadresuar siç duhet, duke riskuar në vijim që inefektivitetin e procesit të pranimit ta shndërronjë apo transmetojë gabimisht në një inefektivitet të Ligjit të Ri 80/2015.

### **Rekomandime**

- a) IAL-të të marrin të gjitha masat e nevojshme për të përcaktuar kritere të qarta, të konvertueshme në formula transparente vlerësimi, të mbështetura në kurrikulën parauniversitare dhe të qëndrueshme në kohë. IAL-të këshillohen që politikën apo strategjinë e tyre të krijojnë përzgjedhëse për pranimet e maturantëve ta përfshijnë dhe publikojnë në Statutet, Rregulloret apo dokumentet e tjera strategjike të tyre.

**Në vijimësi dhe vazhdimisht**

- b) MAS të bëjë kontrollin e përputhshmërisë së kritereve me kurrikulën parauniversitare dhe t'i njoftojë IAL-të për mospërputhjet e mundshme dhe korrektimin e tyre në kohë, duke mos lejuar ndryshimin e kritereve pasi është hapur procesi i aplikimit në QSHA dhe deri në shpalljen e kritereve për vitin apo semestrin pasardhës akademik.

**Në vijimësi dhe vazhdimisht**

- d) MAS të anullojë Udhëzimin nr. 15, dt. 19.05.2017, "Për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit ..., për vitin akademik 2017-2018", sepse ekziston risku potencial që ky udhëzim të dëmtojë sërish efektivitetin e procesit, sikurse efektivitetin e Ligjit për procesin e pranimeve.

**Menjëherë**

### **A krijoi procesi i ndjekur një model të vlefshëm edhe për të ardhmen?**

Kjo nënpyetje finale audituese, nuk është veçse rishprehje e pyetjes kryesore të auditimit, por tashmë e orientuar nga e ardhmja dhe jo nga e kaluara. Standartet ndërkombëtare audituese inkurajojnë auditimet *ex-post* dhe jo *ex-ante*, sepse vetëm e kaluara mund të evidentohet përmes dokumentimit dhe vetëm për të mund të konkludohet me një besueshmëri, objektivitet dhe rilevancë të mjaftueshme.

Nisur nga sa u trajtua më lart në këtë raport, KLSH ka bindjen se nëse performanca e institucioneve përgjegjëse për pranimet në IAL të maturës shtetërore do të vijojë të jetë e njëjtë me atë të vitit 2016, do të ndeshen vazhdimisht probleme në ekonomikitetin, eficiencën dhe efektivitetin e tij. Ndryshimet për përmirësim duhet të mbështeten në zbatimin e Ligjit 80/2015, eksperiencat e mira botërore, bashkëpunimin aktiv mes palëve dhe misionin fisnik për t'i ofruar shoqërisë një arsim publik me kosto sa më të ulët, cilësi sa më të lartë, të orientuar nga tregu dhe zhvillimi, duke e shndërruar atë në një avantazh konkurrues kombëtar, sikurse ka qenë në të kaluarën

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim, ngarkohet Departamenti i Auditimit të Performancës.

**Bujar LESKAJ**

**KRYETAR**